



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr 4242 prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr 15657/1 prot

UDHËZIM

Nr. 2.9 datë 04 08 2011

PËR

“PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË KRYEN AGJENCIA PUBLIKE E AKREDITIMIT TË ARSIMIT TË LARTË”

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 60, nenit 61 dhe nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të nenit 14 të Vendimit nr. 424, datë 02. 06. 2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimit dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë” i ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave,

UDHËZOJMË:

1. Tarifa për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), nga ekspertët e jashtëm, vendas ose të huaj dhe konsulentët, për vlerësimin e aplikimit dhe paraakreditimit të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifa - Ekspert vendas	Tarifa – ekspertizë e huaj në distançë	Tarifa - ekspertizë e huaj - <i>prezent</i>
a) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi dy-vjeçar jouniversitar	188,000	323,000	508,000
b) vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të parë	193,000	338,000	589,000
c) 1. vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të dytë në shkencat sociale dhe humane.	193,000	354,000	636,000
2. vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të dytë në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, inxhinieri, arkitekturë.	215,000	425,000	738,000
ç) 1. vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të tretë në shkencat sociale dhe humane.	209,00	425,000	611,000
2. vlerësim paraprak i një programi të ri studimi të ciklit të tretë për specializimet në fushat e shkencave të mjekësisë humane, veterinari dhe inxhinieri.	215,000	480,000	794,000

2. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), nga ekspertët e jashtëm, vendas ose të huaj, konsulentët për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifat
a) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi institucional i Institucionit të Arsimit të Lartë/filial (ose akreditimi i parë)	1,128,000
1. Një institucion me 1-2 fakultete, filial ose kolegji.	
2. Një universitet me 3-5 fakultete ose filial me 3-5 fakultete	1,965,000
b) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të parë	288,000
1. Me angazhim të ekspertëve vendas	
2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	578,000
c) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të dytë	304,000
1. Me angazhim të ekspertëve vendas	
2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	632,000
ç) Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi i një programi të ri studimi të ciklit të tretë	320,000
1. Me angazhim të ekspertëve vendas	
2. Me angazhim të ekspertëve të huaj	646,000

3. Tarifat për shërbimet që kryen Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), nga ekspertët e jashtëm, për shërbime që nuk përfshihen në pikat 1 dhe 2, si për riorganizimin, ristrukturimin apo shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për hapjen e njësive të jenë si më poshtë në lekë:

Vlerësimet	Tarifat
1. Vlerësimi i aplikimit për riorganizimin e programeve të studimit.	93,000
2. Vlerësimi i aplikimit për ristrukturimin e institucionit.	93,000
3. Vlerësimi i kërkesës për hapjen e një njësie në institucionet e arsimit të lartë	93,000
4. Konsulenca të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë që nuk përfshihen në kategoritë e lartëpërmendura.	93,000

4. Kur pas vlerësimit paraprak në varësi të pikës 1 të këtij udhëzimi (pikat a-ç), ose pas vlerësimit të jashtëm, në varësi të pikës 2 të këtij udhëzimi (pikat a-ç), Këshilli i Akreditimit ose Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, respektivisht sipas kompetencave, vendos kushte për vlerësimin paraprak përfundimtar apo për akreditimin përfundimtar pozitiv dhe nëse institucionit i duhet t'i nënshtrohet sërish procesit të vlerësimit paraprak apo vlerësimit të jashtëm, subjekti paguan sërish por vetëm 35% të tarifës të përcaktuar në varësi të pikave 1 dhe 2 të këtij udhëzimi (pikat a-ç).
5. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 1 të këtij udhëzimi arkëtohet para fillimit të procesit të vlerësimit në APAAL, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
6. Tarifa për çdo vlerësim, e llogaritur sipas pikës 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, arkëtohet para fillimit të procesit të aplikimit në APAAL, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të postës shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.
7. Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë shpërndahen 10% në Buxhetin e Shtetit dhe 90% në buxhetin e Agjencisë.
8. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 06, "Të ardhurat jashtë limitit".

9. Të ardhurat që sigurohen nga këto shërbime për llogari të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë përdoren si më poshtë:

- a) për pagesat e ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj, dhe konsulentëve, të cilat janë kontraktuar nga APAAL;
- b) për të mbuluar shpenzimet operative dhe të funksionimit të Këshillit të Akreditimit;
- c) për pagesën e tarifave të anëtarësimit në organizata ose institucioneve ndërkombëtare;
- ç) për pagesën e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit dhe shpenzimet e tjera të tij;


10. Institucionet e arsimit të lartë të cilët kanë aplikuar për shërbimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi dhe nuk kanë paguar tarifat e përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr. 2 datë 18.01.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", do të paguajnë tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim.

11. Udhëzimi i përbashkët nr. 2, datë 18.01.2011 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave "Për përcaktimin e tarifave të vlerësimit dhe akreditimit për shkollat e larta jopublike", shfuqizohet.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".


MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS


MYQEREM TAFAJ

MINISTRI I FINANCEVE

RIDVAN BODE

NE MUNGËSE E ME POROSI


NEZIR HALDEDA
ZV. MINISTRI

Pa V